

V E N D I M
Nr.334, datë 23.6.2000

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË KONTROLLIT TË DEKLARIMIT TË PASURIVE TË PERSONELIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 dhe 10, të ligjit nr.7903, datë 8.3.1995 “Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve të Shërbimit Publik”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e komisionit për kontrollin e deklarimit të pasurisë së personelit të administratës doganore, me përfaqësues nga:

1. Këshilli i Ministravekryetar
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeveanëtar
3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeveanëtar
4. Drejtoria e Kontrollit Administrativ, në Këshillin e Ministraveanëtar
5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganaveanëtar
6. Ministria e Drejtësisëanëtar
7. Ministria e Financaveanëtar

2. Kryetari dhe anëtarët e komisionit caktohen për një periudhë 1-vjeçare.

3. Brenda 15 ditëve nga dalja e këtij vendimi, institucionet e mësipërme të dërgojnë, pranë Këshillit të Ministrave, emrat e anëtarëve.

4. Pranë komisionit ftohen të marrin pjesë, si vëzhgues, një përfaqësues i Misionit të Organizatës së Sigurimit dhe Bashkëpunimit Europian në Shqipëri, dhe të Misionit të Asistencës Doganore, të Komisionit Europian.

5. Detyrat e këtij komisioni janë:

Verifikimi sistematik i deklarave të pasurive të personelit të administratës doganore, sipas një grafiku të hartuar nga kryetari i komisionit dhe i miratuar nga komisioni. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e tatimeve në rrethet janë të detyruara t’i japin komisionit, sa herë që ai ua kërkon, të gjitha deklaratat e dosjeve personale të secilit punonjës.

Për verifikimin e deklarimeve për pasuritë, komisioni ka të drejtë të shfrytëzojë dokumentacionin e arkivit të tatimpaguesve, të hipotekës, të kadastrës, bankave, Komisionit të kthimit të Pronave, zyrate të noterisë, AKP-së, etj, ku është e regjistruar çdo pasuri të deklaruar, sipas ligjit nr.7903, datë 8.3.1995, “Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të Shërbimit Publik”.

Ruan sekretin për të dhënat që merr nga institucionet dhe zyrat e lartpërmendura.

Ruan konfidencialitetin e deklarimeve të bëra nga nëpunësit.

Brenda vitit 2000 komisioni do të kontrollojë deklaratat e vitit 1999.

Kontrollon, sipas rastit, deklaratat e pasurive të dorëzuara që nga viti 1996 e në vazhdim.

Pasqyron, me dokumentacion të veçantë, të gjithë veprimtarinë kontorlluese që kryen.

Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për t’u njohur me rastet e përfshirjes në korrupsion, të cilat janë vënë re nga nëpunësit e kësaj drejtorie, dhe masat e marra.

Për kundërvajtjet administrative, u propozon organeve përgjegjëse zbatimin e dënimeve që parashikojnë nenet 8 dhe 9, të ligjit nr.7903, datë 8.3.1995.

Njofton, me shkrim, çdo 3 muaj Kryeministrin, ministrin e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për kontrollin e ushtruar dhe rezultatet e dala gjatë kontrollit.

Bën sugjerimet e nevojshme për ndryshimin e ligjit nr.7903, datë 8.3.1995.

6. Kryetari dhe anëtarët e komisionit, paguhet për orët shtesë, jashtë kohës së orarit zyrtar, në masën që përcakton vendimi nr.761, datë 19.11.1998, i Këshillit të Ministrave, “Për kohën e punës dhe të pushimit në Shërbimin Civil”.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga dhënia e shpërblimit të komisionit, përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta